



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

**BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË**

Nr. 1668/2 prot

Libohovë më 07.08.2026

VENDIM

Nr. 43 , Datë 03.08.2026

**PËR NGRITJEN E KOMISIONIT LIDHUR ME SHQYRTIMIN E
PROPOZIMIT PËR REFORMËN - TERRITORIALE 2.0**

Këshilli Bashkiak Libohovë në mbledhjen e tij të jashtëzakonshme të datës 03.08.2026, në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, projekt-draftit për Reformën Administrative-Territoriale 2.0, me propozim të anëtarë të Këshillit Bashkiak Libohovë :

VENDOSI

I. Të ngrihet një komision për shqyrtimin e propozimit për Reformën Administrative - Territoriale 2.0 me përbërje si më poshtë vijon:

- Leonard Hide Kryetar i Bashkisë
- Asim Banushaj Kryetar i Këshillit Bashkiak
- Altin Çomo Anëtarë i Këshillit Bashkiak
- Krenar Kulla Anëtarë i Këshillit Bashkiak
- Emin Beqari Anëtarë i Këshillit Bashkiak
- Kristaq Ciko Specialis Jurist pranë bashkisë

II. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Rahim Skënderi

Miratur me 12 (dymbëdhjetë) vota
Vota Pro : 12 (dymbëdhjetë) vota
Vota Kundër : asnjë
Vota Abstenim : asnjë



KRYETARI I KËSHILLIT

Asim Banushaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË

Nr. 1668/3 prot

Libohovë më 07.08.2026

VENDIM

Nr. 44 , Datë 03.08.2026

PËR
SHPREHJEN E MOSDAKORDËSISË SË KËSHILLIT BASHKIAK
LIBOHOVË ME PROPOZIMIN PËR BASHKIMIN E BASHKISË LIBOHOVË
ME BASHKINË GJIROKASTËR

Këshilli i Bashkisë Libohovë në mbledhjen e jashtëzakonshme të datës 03.08.2026, në mbështetje të:

- nenit 13 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, i cili cili parashikon "Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë, ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore"
- Neni 108, pika 2 i cili përcakton "Ndarja administrativo-territoriale caktohet me ligj, mbi bazën e nevojave dhe interesave të përbashkët ekonomikë, si dhe të traditës historike, ndërsa ndryshimi i kufijve kushtëzohet nga marrja paraprake e mendimit të popullsisë që banon në njësitë e prekura" dhe vijues të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, lidhur me organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore;
- Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore, ratifikuar nga Republika e Shqipërisë me ligjin nr. 8548, datë 11.11.1999, e cila në nenin 5 të saj përcakton

Neni 5 i Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore shprehet:

Mbrojtja e kufijve territorial të bashkësive vendore

- Për çdo ndryshim të kufijve territorial vendorë, bashkësive vendore përkatëse duhet t'u merret mendimi parapraksht, po qe nevoja, me anë referendumi, aty ku e lejon ligji;
- ligjit nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore", i ndryshuar, i cili përcakton misionin, funksionet dhe autonominë e njësive të vetëqeverisjes vendore;

- ligjit nr. 44/2015 "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë", lidhur me parimet e transparencës, ligjshmërisë dhe marrjes në konsideratë të interesave të palëve të prekura;

Duke marrë në konsideratë:

- rolin kushtetues të njësive të vetëqeverisjes vendore si institucione të zgjedhura drejtpërdrejt nga qytetarët;
- faktin se Bashkia Libohovë përfaqëson një komunitet me histori, identitet kulturor, tradita dhe lidhje të konsoliduara shoqërore e territoriale;
- shqetësimin e komunitetit vendor lidhur me pasojat që mund të sjellë shkrirja e Bashkisë Libohovë në drejtim të përfaqësimit qytetar, aksesit në shërbime publike, zhvillimit të territorit dhe ruajtjes së identitetit vendor;
- domosdoshmërinë që çdo reformë administrativo-territoriale të mbështetet në studime të plota, të matshme dhe transparente mbi ndikimin ekonomik, social, administrativ dhe territorial;

KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË KONSTATON SE:

- Reforma administrativo-territoriale është një proces me rëndësi të veçantë për funksionimin e demokracisë vendore dhe për këtë arsye duhet të realizohet vetëm pas një analize të thelluar dhe një konsultimi real me komunitetet e prekura.
- Shkrirja e një njësie të zgjedhur vendore nuk mund të konsiderohet vetëm si një ndryshim administrativ, pasi prek drejtpërdrejt të drejtën e qytetarëve për përfaqësim sa më pranë tyre dhe administrim efektiv të interesave lokale.
- Çdo ndryshim territorial duhet të garantojë se qytetarët do të kenë akses më të mirë në shërbime publike, administratë dhe vendimmarrje, dhe jo të krijojë largim të mëtejshëm të institucioneve nga komuniteti.
- Bashkia Libohovë ka një rol të rëndësishëm në ruajtjen e trashëgimisë historike, kulturore dhe sociale të zonës, ndaj çdo vendimmarrje për ndryshimin e statusit të saj duhet të marrë në konsideratë edhe këto elemente.
- Këshilli Bashkiak i Libohovës, si organi përfaqësues i zgjedhur nga qytetarët, shpreh qëndrimin e komunitetit që përfaqëson dhe kërkon që zëri i banorëve të dëgjohet dhe të merret në konsideratë në procesin e vendimmarrjes.

PËR KËTO ARSYE,

Këshilli Bashkiak i Libohovës

Vendosi:

- Të shprehë mosdakordësinë e Këshillit Bashkiak Libohovë, lidhur me propozimin për bashkimin e Bashkisë Libohovë, me Bashkinë Gjirokastrë
- Të deklarojë se ky qëndrim shpreh jo vetëm vullnetin institucional të Këshillit Bashkiak, por edhe shqetësimin dhe interesin e banorëve të Bashkisë Libohovë, të cilët kërkojnë ruajtjen e përfaqësimit të tyre vendor.
- T'i kërkojë Kuvendit të Republikës së Shqipërisë që, përpara çdo vendimmarrjeje për ndryshime administrativo-territoriale, të zhvillojë një proces të plotë konsultimi me njësitet vendore dhe komunitetet e prekura.

- T'i kërkojë Këshillit të Ministrave dhe ministrisë përgjegjëse për çështjet e pushtetit vendor që të bëjnë publike analizat, kriteret dhe argumentet mbi të cilat është mbështetur propozimi për ndryshimin e kufijve administrativo-territorialë.
- Të kërkojë që mendimi i Këshillit Bashkiak të Libohovës dhe i komunitetit të saj t'i bashkëlidhet dokumentacionit zyrtar të procesit të shqyrtimit të projektaktit.

Të njoftojë për këtë qëndrim:

- Kuvendin e Republikës së Shqipërisë;
- Komisionet parlamentare përgjegjëse;
- Deputetët e Qarkut Gjirokastrë;
- Ministrinë përgjegjëse për çështjet e qeverisjes vendore;
- Institucionet dhe grupet e interesit që lidhen me këtë proces.
- Të autorizojë Kryetarin e Këshillit Bashkiak dhe Kryetarin e Bashkisë Libohovë për ndjekjen e procedurave të mëtejshme institucionale dhe paraqitjen e këtij qëndrimi pranë institucioneve qendrore.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë .

Anëtarë gjithsej	Të pranishëm	Pro	Kundër / Abstenim
15	12	12	

Miraturar në mbledhjen e Këshillit Bashkiak Libohovë, më datë 03.08.2026.

SEKRETARI I KËSHILLIT

Rahim Skënderi

Miraturar me 12 (dymbëdhjetë) vota
 Vota Pro : 12 (dymbëdhjetë) vota
 Vota Kundër : asnjë
 Vota Abstenim : asnjë



KRYETARI I KËSHILLIT

Asim Banushaj



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË

Nr. 1668/4 prot

Libohovë më 07.08.2026

VENDIM

Nr. 45, Datë 03.08.2026

**PËR
MIRATIM MEMORANDUMI**

Këshilli Bashkiak Libohovë në mbledhjen e tij të jashtëzakonshme të datës 03.08.2026, në mbështetje të ligjit nr.139/2015, "Për vetëqeverisjen vendore", të ndryshuar, projekt-draftit për Reformën Administrative-Territoriale 2.0, me propozim të anëtarëve të Këshillit Bashkiak Libohovë :

VENDOSI

I.Të miratojë Memorandumin e propozuar nga një grup këshilltarësh të Këshillit Bashkiak

II.Ky vendim hyn në fuqi menjëherë,

SEKRETARI I KËSHILLIT

Rahim Skënderi

Miratuar me 12 (dymbëdhjetë) vota
Vota Pro : 12 (dymbëdhjetë) vota
Vota Kundër : asnjë
Vota Abstenim : asnjë



KRYETARI I KËSHILLIT

Asim Banushaj



RELACION PËR PARAQITJEN E MEMORANDUMIT NË KËSHILLIN BASHKIAK LIBOHOVË

I nderuar Kryetar i Këshillit, Të nderuar Këshilltarë,

Memorandumi që paraqitet për shqyrtim është hartuar mbi bazën e Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, Ligjit nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore", Kartës Evropiane të Autonomisë Vendore dhe praktikave më të mira evropiane të organizimit të pushtetit vendor.

Qëllimi i tij nuk është kundërshtimi i reformave administrative, por paraqitja e argumenteve ligjore, historike, institucionale, gjeografike, ekonomike dhe turistike që mbështesin ruajtjen dhe forcimin e Bashkisë Libohovë. Memorandumi propozon një qasje konstruktive, duke evidentuar se Libohova, si një bashki me identitet historik, pozitë kufitare dhe potencial të rëndësishëm zhvillimi, meriton një trajtim të veçantë institucional në përputhje me standardet evropiane të vetëqeverisjes vendore.

Për këto arsye, kërkohet që Këshilli Bashkiak ta marrë në shqyrtim këtë memorandum, ta vlerësojë dhe, nëse e gjykon të arsyeshëm, ta miratojë si një dokument zyrtar për t'ua përcjellë institucioneve përgjegjëse të Republikës së Shqipërisë.

I. HYRJE

Ky relacion paraqitet për shqyrtim në Këshillin Bashkiak Libohovë, me qëllim prezantimin e memorandumit mbi statusin, rolin dhe perspektivën e zhvillimit të Bashkisë Libohovë, në kushtet e diskutimeve për reformimin e mëtejshëm territorial dhe administrativ.

II. BAZA LIGJORE

Memorandumi mbështetet në: Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, nenet 108–115, që garantojnë vetëqeverisjen vendore; Ligjin nr. 139/2015 "Për vetëqeverisjen vendore"; Ligjin nr. 115/2014 "Për ndarjen administrativo-territoriale"; Kartën Evropiane të Autonomisë Vendore (ratifikuar nga Shqipëria); Parimin e subsidiaritetit dhe praktikën më të mira evropiane në organizimin e pushtetit vendor.

III. QËLLIMI I MEMORANDUMIT

Qëllimi i memorandumit është të paraqesë në mënyrë të argumentuar dhe institucionale vlerat historike, gjeografike, ekonomike dhe turistike të Bashkisë Libohovë, si dhe të evidentojë nevojën për ruajtjen dhe forcimin e saj si njësi e vetëqeverisjes vendore. Memorandumi nuk synon kundërshtim formal të reformave, por ofron një qasje konstruktive dhe të bazuar në ligj, në përputhje me standardet evropiane.

IV. ARGUMENTET KRYESORE

Libohova përfaqëson një njësi me identitet të konsoliduar historik dhe administrativ; Pozita e saj gjeografike kufitare kërkon një administrim të drejtpërdrejtë dhe funksional; Ka potencial të rëndësishëm për zhvillim agro-turistik dhe ekonomik; Praktikën evropiane njohin dhe mbështesin ekzistencën e njërive të vogla me rëndësi historike dhe turistike. V. PROPOZIMI Propozohet që Këshilli Bashkiak Libohovë: Të marrë në shqyrtim memorandumin e paraqitur; Ta vlerësojë atë në aspektin ligjor dhe institucional; Nëse e

gjykon të arsyeshëm, ta miratojë si dokument zyrtar; Ta përcjellë atë pranë institucioneve qendrore përkatëse për shqyrtim të mëtejshëm.

V. PËRFUNDIME

Memorandumi përfaqëson një kontribut serioz dhe të argumentuar për të ardhmen institucionale të Bashkisë Libohovë dhe meriton të trajtohet me përgjegjësi dhe vizion zhvillimi afatgjatë.

Duke ju falënderuar,

Libohovë më 3.08.2026

Përgatiti dhe prezantoi : Një grup këshilltarësh nga Këshilli Bashkiak

DISKUTIM NË DËGJESËN PUBLIKE MBI TË ARDHMEN ADMINISTRATIVE TË BASHKISË SË LIBOHOVËS

Të nderuar pjesëmarrës,

Së pari, duam të falënderojmë organizatorët për mundësinë që na jepet të shprehim mendimet tona në këtë dëgjese publike, e cila ka një rëndësi të veçantë për të ardhmen e organizimit territorial dhe të qeverisjes vendore. Qëndrimi ynë në këtë diskutim mbështetet në një parim të qartë:

ÇDO REFORMË ADMINISTRATIVE DUHET TË NDËRTOHET MBI HISTORINË, LIGJIN, INTERESIN PUBLIK DHE PERSPEKTIVËN E ZHVILLIMIT TË TERRITORIT. LIBHOVA NUK ËSHTË NJË NJËSI ADMINISTRATIVE E KRIJUAR RISHTAZI. AJO KA NJË VAZHDIMËSI INSTITUCIONALE MË SHUMË SE NJË SHEKULL.

● VAZHDIMËSIA HISTORIKE DHE ADMINISTRATIVE E LIBOHOVËS

Në vitin 1914, Libohova u shpall Nënprefekturë. Ky vendim nuk ishte rastësor, por lidhej me pozitën e saj strategjike kufitare, traditën administrative, rëndësinë historike dhe aftësinë për të administruar një territor me veçori të veçanta. SHALLJA E LIBOHOVËS NË NËNPREFEKTURË NË VITIN 1914 ISHTE NJOHJE E ROLIT TË SAJ SI QENDËR ADMINISTRATIVE DHE

STRATEGJIKE NË JUGUN E SHQIPËRISË. Në juridiksionin e Nënprefekturës u përfshinë edhe zona të banuara nga minoriteti kombëtar grek. Kjo dëshmonte besimin që shteti shqiptar i kishte dhënë Libohovës për administrimin e një territori me rëndësi të veçantë dhe për garantimin e zbatimit të ligjit, rendit dhe bashkëjetesës ndërmjet komuniteteve. Edhe sot, në territorin e Bashkisë së Libohovës jetojnë qytetarë që i përkasin minoritetit kombëtar grek, të cilëve u garantohen të drejtat dhe garancitë e parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, legjislacioni shqiptar dhe konventat ndërkombëtare.

LIBOHOVA KA QENË DHE MBETET NJË HAPËSIRË E BASHKËJETESËS, RESPEKTIT RECIPROK DHE ADMINISTRIMIT INSTITUCIONAL PËR TË GJITHË QYTETARËT.

Pas vitit 1944, organizimi i pushtetit vendor ndryshoi sipas zhvillimeve politike të vendit, por Libohova vazhdoi të ruante rolin e saj administrativ. Ajo kaloi në forma të ndryshme organizimi:

NËNPREFEKTURË → LOKALITET → KËSHILL POPULLOR → KËSHILL PLURALIST → BASHKI → BASHKI ME TERRITOR TË ZGJERUAR. KY EVOLUCION TREGON SE LIBOHOVA NUK KA KALUAR NË RRUGËN E TKURRJES ADMINISTRATIVE, POR NË RRUGËN E ZHVILLIMIT DHE PËRSHTATJES INSTITUCIONALE.

Reformat kanë ndryshuar format e organizimit, por nuk kanë mohuar rolin e Libohovës si qendër e administrimit vendor. LIBOHOVA DHE PERSPEKTIVA E ZHVILLIMIT Reforma administrativo-territoriale e vitit 2015 nuk e hoqi statusin e Libohovës, por e zgjeroi territorin e saj dhe i dha përgjegjësi të reja. Kjo tregon se zgjidhja ka qenë forcimi i funksioneve të saj dhe jo eliminimi i rolit të saj institucional. Në vlerësimin e një reforme të re nuk mund të përdoren vetëm tregues numerikë.

NJË TERRITOR NUK ËSHTË VETËM NUMËR BANORËSH APO SIPËRFAQE. AI ËSHTË HISTORI, IDENTITET, TRASHËGIMI, KULTURË, BURIME NATYRORE DHE MUNDËSI ZHVILLIMI.

Libohova ka vlera të rëndësishme historike e kulturore, pozitë strategjike kufitare dhe potencial të madh për zhvillimin e agro-turizmit, turizmit kulturor dhe ekonomisë lokale. Për t'i kthyer këto vlera në zhvillim nevojitet një qeverisje që njeh territorin, është pranë qytetarit dhe ka mundësi të marrë vendime sipas nevojave reale të komunitetit.

● MBI KONCEPTIN E QEVERISJES ME "QYTET"

Në diskutimin për reformën e ardhshme territoriale duhet të vlerësohet me kujdes edhe koncepti i qeverisjes me "qytet". Një njësi më e madhe administrative nuk do të thotë automatikisht zhvillim më i madh.

MADHËSIA E NJË STRUKTURE ADMINISTRATIVE NUK ËSHTË MASA E ZHVILLIMIT TË SAJ. ZHVILLIMI MATET ME EFEKTIVITETIN, AFËRSINË ME QYTETARIN DHE AFTËSINË PËR TË ZHVILLUAR TERRITORIN.

Për një territor si Libohova, me histori të gjatë administrative, me zona rurale dhe malore dhe me pasuri të veçanta, përqendrimi i vendimmarrjes në një qendër më të madhe rrezikon të dobësojë përfaqësimin lokal dhe lidhjen e institucionit me qytetarin.

NJË MODEL QË LARGON VENDIMMARRJEN NGA KOMUNITETI DHE DOBËSON VETËQEVERISJEN VENDORE NUK ËSHTË ZHVILLIM, POR REGRES INSTITUCIONAL.

Modelet moderne evropiane tregojnë se edhe njësitë e vogla vendore mund të jenë të suksesshme kur kanë administratë profesionale, përdorin teknologjinë, menaxhojnë mirë burimet dhe ndërtojnë politika të përshtatura për territorin. Prandaj pyetja kryesore nuk duhet të jetë: "SA E MADHE ËSHTË NJË NJËSI ADMINISTRATIVE?" por: "SA E AFTË ËSHTË AJO PËR T'I SHËRBYER QYTETARIT DHE PËR TË ZHVILLUAR TERRITORIN?"
KËRKESË DREJTUAR PËRFAQËSUESVE INSTITUCIONALË

Në përfundim, dëshiroj t'u drejtohem deputetëve të pranishëm, përfaqësuesve të institucioneve vendore dhe të gjithë aktorëve që janë pjesë e këtij procesi. Ju kërkoj që historia administrative e Libohovës, vazhdimësia e saj institucionale, vlerat e territorit dhe mbi të gjitha zëri i komunitetit të merren në konsideratë me përgjegjësi.

KJO NUK ËSHTË VETËM ÇËSHTJE E NJË STRUKTURE ADMINISTRATIVE. ËSHTË ÇËSHTJE E RUAJTJES SË NJË HISTORIE, NJË IDENTITETI DHE NJË VAZHDIMËSIE INSTITUCIONALE.

Ju kërkojmë që ky zë i qytetarëve të Libohovës të përcillet në Kuvendin e Republikës së Shqipërisë dhe të merret në konsideratë gjatë procesit të vendimmarrjes.

LIBOHOVA NUK KËRKON NJË PRIVILEGJ. AJO KËRKON RESPEKTIMIN E HISTORISË, ROLIT TË SAJ INSTITUCIONAL DHE TË DREJTËS PËR TË VAZHDUAR ZHVILLIMIN. KËRKOJMË QË LIBOHOVA TË MBETET NJËSI E VETËQEVERISJES VENDORE, ASHTU SIÇ KA QENË NË VAZHDIMËSI DHE ASHTU SIÇ E MERITON.

Ky është një apel për dialog institucional, për një vlerësim të drejtë dhe për një vendimmarrje që të shohë jo vetëm hartën administrative, por edhe njerëzit, historinë dhe të ardhmen e këtij territori.

FALEMINDERIT!

MEMORANDUM

MBI MODELIMIN E ZHVILLIMIT DHE ADMINISTRIMIT TË TERRITORIT TË BASHKISË LIBOHOVË

Libohova – një model i bashkisë me vlera të veçanta historike, kulturore, natyrore dhe agroekoturistike

Rasti i Bashkisë Libohovë

Të nderuar këshilltarë!

Prej muajsh kemi ndarë me ju mendime dhe argumente në mbështetje të vazhdimësisë së Bashkisë Libohovë. Kemi ndjekur me vëmendje edhe reagimet e shumta të qytetarëve, të cilat tregojnë interes dhe përkushtim për këtë çështje.

Megjithatë, kemi vënë re se diskutimi shpesh mbështetet kryesisht te historia dhe te reagimet emocionale, ndërsa mungojnë argumentet e plota ligjore, institucionale, ekonomike, mjedisore dhe zhvillimore, të cilat janë po aq të domosdoshme për një vendimmarrje serioze.

Pikërisht për këtë arsye është përgatitur ky memorandum. Ai përfaqëson një analizë të argumentuar dhe një vizion për të ardhmen e Bashkisë Libohovë, të mbështetur në parimet e vetëqeverisjes vendore, në praktikat më të mira evropiane dhe në potencialet reale të territorit tonë.

Për të mos mbetur një dokument i njohur vetëm nga një numër i kufizuar njerëzish, kemi vendosur ta bëjmë publike për të gjithë, të ndarë në pesë kapituj, në mënyrë që secili të lexohet me qetësi, të analizohet dhe të gjykohet mbi bazën e argumenteve.

Ky memorandum nuk synon të krijojë polemika, ndasi apo debate të kota. Ai synon të kontribuojë me argumente serioze dhe të verifikueshme për një vendimmarrje të drejtë, të mbështetur në ligj, në interesin publik dhe në perspektivën afatgjatë të zhvillimit të Bashkisë Libohovë. Nëse ky dokument ndihmon në ngritjen e nivelit të debatit publik, nxit reflektim dhe orienton diskutimin drejt zgjidhjeve konkrete, atëherë ai e ka përmbushur misionin e tij.

HYRJE

Libohova – një shekull vazhdimësi në organizimin e pushtetit vendor

Historia e organizimit të pushtetit vendor në Libohovë nuk është historia e një njësie administrative të krijuar rastësisht. Ajo është historia e një evolucioni të pandërprerë institucional, i ndërtuar mbi më shumë se një shekull përvojë, përgjegjësi dhe besim të shtetit shqiptar. Një moment themelor në këtë histori është viti 1914, kur Libohova u shpall Nënprefekturë. Ky vendim nuk ishte formal, por rezultat i pozitës së saj strategjike kufitare, traditës administrative, rëndësisë historike dhe aftësisë për të administruar një territor me përbërje të larmishme shoqërore.

Në juridiksionin e Nënprefekturës u përfshinë edhe zona të banuara nga minoriteti kombëtar grek, duke dëshmuar besimin që shteti shqiptar i dha Libohovës për administrimin e një territori me rëndësi të veçantë dhe për garantimin e zbatimit të ligjit, rendit dhe bashkëjetesës. Edhe sot, në territorin e Bashkisë së Libohovës jetojnë qytetarë që i përkasin minoritetit kombëtar grek, të cilët gëzojnë të drejtat dhe garancitë e parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, legjislacioni në fuqi dhe konventat ndërkombëtare.

Pas vitit 1944, me ndryshimin e sistemit shtetëror, organizimi i pushtetit vendor u përshtat me strukturat e reja administrative. Libohova vazhdoi të ruante funksionin e saj si qendër e administrimit lokal, duke kaluar në forma të ndryshme organizimi: Lokalitet, si njësi e administrimit vendor; Këshill Popullor, sipas organizimit të pushtetit vendor të periudhës së atëhershme; Këshill pluralist, pas vitit 1991, me vendosjen e sistemit demokratik dhe zgjedhjen e përfaqësuesve vendorë nga qytetarët; Bashki, në kuadrin e vetëqeverisjes vendore demokratike; Bashki me territor të zgjeruar, pas reformës administrativo-territoriale të vitit 2015.

Ky evolucion tregon se ndryshimet administrative në Libohovë kanë qenë pjesë e zhvillimit të shtetit shqiptar, por pa ndërprerë rolin e saj si qendër e pushtetit vendor. Në çdo periudhë, funksionet janë përshtatur me kërkesat e kohës, duke ruajtur identitetin dhe përgjegjësinë institucionale të kësaj qendre historike. Për më shumë se një shekull, Libohova ka shërbyer si një pikë referimi administrative, kulturore dhe shoqërore për territorin përreth. Pozita e saj kufitare, trashëgimia historike, pasuritë natyrore dhe kapacitetet zhvillimore e bëjnë atë një rast të veçantë që duhet vlerësuar në çdo reformë të ardhshme territoriale.

Ky memorandum mbështetet në bindjen se organizimi i pushtetit vendor nuk mund të vlerësohet vetëm mbi tregues numerikë, por duhet të marrë në konsideratë edhe historinë institucionale, identitetin territorial, funksionin strategjik dhe mundësitë reale të zhvillimit. Mbi këtë bazë historike dhe institucionale ndërtohen edhe argumentet e mëposhtme të këtij memorandumi, të cilat trajtojnë vlerat, potencialet dhe rolin e ardhshëm të Bashkisë së Libohovës në zhvillimin e qëndrueshëm të territorit.

Territoret me histori të veçantë, pasuri kulturore, burime natyrore dhe potenciale ekonomike nuk mund të trajtohen vetëm me logjikën e administrimit të zakonshëm. Ato kërkojnë një qasje të re, ku identiteti historik, trashëgimia kulturore, mjedisi, prodhimet tradicionale dhe komuniteti të shihen si pjesë të një sistemi të vetëm zhvillimi. Libohova dhe territori përreth saj përfaqësojnë një hapësirë me vlera të rëndësishme historike, kulturore, natyrore dhe ekonomike. Këto vlera nuk janë vetëm pjesë e kujtesës së së kaluarës, por përbëjnë një bazë reale për zhvillimin e ardhshëm.

Qëllimi i këtij memorandumi nuk është vetëm evidentimi i pasurive, por paraqitja e një modeli konkret se si ato mund të administrohen, mbrohen dhe shndërrohen në burime zhvillimi për komunitetin.

Parimi themelor është: Një territor nuk zhvillohet vetëm nga ajo që trashëgon, por nga mënyra se si e menaxhon dhe e kthen atë në vlerë.

I. LIBOHOVA – TERRITOR ME IDENTITET TË VEÇANTË HISTORIK, KULTUROR, NATYROR DHE EKONOMIK

Libohova përfaqëson një territor me një trashëgimi të pasur historike dhe kulturore, ku ndërthuren vlera të lashta, tradita të ruajtura ndër breza dhe burime të rëndësishme natyrore.

Pozicioni i saj gjeografik, historia mijërvjeçare dhe lidhja e fortë e komunitetit me territorin e bëjnë atë një zonë me identitet të veçantë në Shqipëri.

Pasuritë kryesore të saj përfshijnë:

objekte dhe gjurmë të trashëgimisë historike e arkeologjike;

kala, kulla, objekte kulti dhe monumente të traditës;

peizazhe natyrore, pyje, kullota dhe burime ujore;

prodhime tradicionale bujqësore e blegtorale;

tradita të pasura të kuzhinës dhe mikpritjes.

Ndër vlerat më përfaqësuese përmenden:

Kalaja e Libohovës;
sarajet e Mufid beut;
varret monumentale dhe ato të bejlerëve;
varri monumental i Shanishasë;
Kulla e Sahatit;
objekti i kultit romak i shekullit I p.K.;
varret pagane;
fshati dhe kisha e Stojanit;
burimi i ujit të Zhepës;
qyteti antik dhe Teqeja e Melanit në Nepravishtë;
Manastiri në Drino;
Kisha e Shën Marisë dhe Shën Dhimitrit në Labovën e Kryqit;
lumi i Suhës dhe Ura e Zonjës;
Manastiri i Stegopulit;
pasuritë e shumta fetare dhe kulturore të Zagorisë.

Këto vlera nuk duhet të trajtohen vetëm si objekte për t'u vizituar, por si pasuri që duhet të marrin jetë përmes administrimit, interpretimit dhe përdorimit të mençur.

Një monument nuk duhet të jetë vetëm një strukturë fizike. Ai duhet të tregojë historinë e tij, të krijojë përvojë për vizitorin dhe të kontribuojë në ekonominë lokale.

Pasuritë natyrore dhe prodhimet tradicionale

Territori i Libohovës dhe zonave përreth dallohet edhe për pasuritë natyrore dhe prodhimet tradicionale me cilësi të veçantë.

Zona njihet për:

djathin tradicional të deles;
prodhimet e tjera blegtorale;
mjaltin;

bimët mjekësore natyrore si çaji i malit, sherebela dhe rigoni;
kultivimin e pemëve frutore;
ullinjtë;
agrumet;

produktet e kuzhinës tradicionale mesdhetare.

Këto produkte lidhen me një territor ku mbizotërojnë metoda tradicionale të prodhimit dhe potenciale për zhvillimin e produkteve biologjikisht të pastra.

Krijimi i markave territoriale si:

Djathë dele Libohove;
Arrë Labova e Kryqit;
Çaj mali Bureto;
Rigon dhe sherebelë mali Bureto;
Mjaltë Zagorie;

mund të shndërrohet në një drejtim të rëndësishëm ekonomik dhe promovues për territorin.

II. ADMINISTRIMI I VLERAVE HISTORIKE, KULTURORE DHE NATYRORE – NGA EVIDENTIMI TEK MENAXHIMI AKTIV

Një nga problemet kryesore të territoreve me pasuri të mëdha historike, kulturore dhe natyrore është se shpesh ato evidentohen, fotografohen dhe promovohen, por nuk shoqërohen me një mënyrë konkrete administrimi dhe funksionimi.

Një qasje bashkëkohore kërkon kalimin nga koncepti:

“Vizito dhe shiko”

tek koncepti:

“Vizito, mëso, përjeto dhe kontribuo në zhvillimin e territorit.”

Çdo pasuri e territorit duhet të trajtohet si një vlerë që ka identitet, histori, funksion dhe mundësi ekonomike.

Një kala, një manastir, një kishë, një urë historike, një zonë arkeologjike apo një peizazh natyror nuk duhet të mbetet vetëm një objekt fizik. Ato duhet të krijojnë një përvojë të plotë për vizitorin. Për shembull, një vizitë në kalanë e Libohovës nuk duhet të kufizohet në shpjegimin e disa të dhënave historike nga një ciceron, por duhet të krijojë mundësinë që vizitori të kuptojë jetën e asaj periudhe:

historinë e familjeve që kanë jetuar aty;

mënyrën e jetesës;

traditat;

arkitekturën;

ushqimin tradicional;

lidhjen e kalasë me komunitetin.

Pra, monumenti duhet të “flasë” përmes elementeve konkrete: ambienteve të interpretuara, materialeve informuese, teknologjisë, aktiviteteve kulturore dhe përvojave të organizuara.

1. Trajtimi i trashëgimisë si ekonomi kulturore

Çdo resurs historik, kulturor dhe natyror duhet të shihet edhe në konceptin ekonomik.

Kjo nuk do të thotë komercializim i trashëgimisë, por përdorim i mençur i saj për të krijuar:

vende pune;

të ardhura për komunitetin;

shërbime turistike;

produkte kulturore;

mundësi për të rinjtë.

Një monument i menaxhuar mirë mund të jetë një burim zhvillimi për zonën ku ndodhet.

Për këtë kërkohet:

plan menaxhimi për çdo pasuri kryesore;

mirëmbajtje dhe restaurim sipas kriterëve profesionale;

promovim i organizuar;

përfshirje e komunitetit lokal;

lidhje me turizmin kulturor dhe agroekoturizmin.

2. Nga objektet e heshtura te identiteti i gjallë

Sot shumë objekte historike ruajnë vetëm strukturat fizike, por kanë humbur pjesën interpretuese dhe funksionale.

Që ato të kthehen në identitetin e tyre real, duhet që vizitori të mos jetë vetëm kalimtar, por pjesëmarrës në një përvojë.

Koncepti duhet të jetë:

“Jo vetëm të shohësh një objekt, por të kuptosh jetën që ai përfaqëson.”

Kjo kërkon ide konkrete:

muzealizim të hapësirave të përshtatshme;

ekspozime historike;
përdorim të teknologjisë digjitale;
aktivitete kulturore;
rikrijim të elementeve të traditës;
lidhje me prodhimet dhe kuzhinën vendore.

3. Administrimi i pasurive natyrore

Përveç trashëgimisë kulturore, territori i Libohovës ka burime të rëndësishme natyrore:

pyje;

kullota;

burime ujore;

biodiversitet të pasur;

bimësi mjekësore dhe aromatike;

peizazhe malore.

Këto pasuri duhet të menaxhohen në mënyrë të qëndrueshme, duke ruajtur ekuilibrin midis mbrojtjes së natyrës dhe zhvillimit ekonomik.

Kullotat polifite, pyjet dhe bimët mjekësore nuk janë vetëm burime natyrore, por pjesë e identitetit dhe ekonomisë së zonës.

4. Përgjegjësia institucionale

Administrimi i këtyre vlerave kërkon ndarje të qartë përgjegjësisë.

Nuk mjafton që dikush të deklarojë:

“E vizitova, e pashë, e propozova.”

Duhet të përcaktohet:

kush është përgjegjës;

çfarë duhet të realizohet;

brenda cilit afat;

me çfarë burimesh;

si matet rezultati.

Vetëm kështu kalohet nga fjalët te veprimi dhe nga promovimi formal te zhvillimi real.

III. ZHVILLIMI EKONOMIK I TERRITORIT PËRMES AGROEKOTURIZMIT DHE PRODUKTEVE ME IDENTITET

Libohova dhe territori përreth saj nuk duhet të shihen vetëm si një hapësirë me histori dhe tradita, por si një territor që ka mundësi reale për të krijuar ekonomi të qëndrueshme mbi bazën e burimeve të veta.

Zhvillimi i ardhshëm duhet të mbështetet në lidhjen e tre elementeve kryesore:
trashëgimi – natyrë – prodhim.

Kjo do të thotë që monumentet historike, peizazhi natyror dhe produktet tradicionale të mos trajtohen të ndara, por si pjesë e një modeli të vetëm zhvillimi.

Zona dallohet për:

blegtorinë tradicionale dhe veçanërisht djathin e deles;

prodhimet e tjera blegtorale;

bletarinë dhe mjaltin;

bimët mjekësore dhe aromatike;

pemtarinë;

ullishtet;

agrumet;
kuzhinën tradicionale mesdhetare;
pyjet dhe kullotat natyrore.

Këto burime përbëjnë bazën për krijimin e një ekonomie territoriale me produkte të veçanta dhe me identitet të dallueshëm.

1. Krijimi i markave territoriale

Një drejtim i rëndësishëm është krijimi i markave ekskluzive që lidhen me origjinën dhe cilësinë e zonës:

Djathë dele Libohove;

Arrë Labova e Kryqit;

Çaj mali Bureto;

Rigon dhe sherebelë mali Bureto;

Mjaltë Zagorie.

Këto produkte duhet të shoqërohen me:

dokumentim të origjinës;

standardizim cilësie;

paketim profesional;

promovim të organizuar;

lidhje me strukturat turistike.

2. Panairet agroekoturistike si instrument zhvillimi

Organizimi i panaireve lokale dhe kombëtare agroekoturistike duhet të jetë një veprimtari ekonomike dhe promovuese reale, jo një aktivitet formal.

Panairet duhet të shërbejnë për:

promovimin e produkteve vendore;

lidhjen e prodhuesve me tregun;

nxitjen e investimeve;

prezantimin e traditës dhe kuzhinës;

krijimin e bashkëpunimeve të reja.

Vlera e një aktiviteti nuk matet nga numri i fjalimeve, por nga rezultatet konkrete që sjell.

3. Libohova si model agroekoturistik

Qëllimi duhet të jetë krijimi i një modeli ku vizitori:

njeh historinë;

përjeton natyrën;

shijon produktet vendore;

kupton traditat;

kontribuon në ekonominë lokale.

Libohova mund të shndërrohet në një model kombëtar të bashkisë agroekoturistike, ku identiteti territorial kthehet në burim zhvillimi.

IV. MODELI I ADMINISTRIMIT AKTIV DHE PËRGJEGJËSITË KONKRETE

Nga pasuria e evidentuar te pasuria e menaxhuar

Një territor nuk zhvillohet vetëm sepse ka vlera, por sepse ka aftësi t'i administrojë ato.

Parimi themelor është:

Çdo pasuri duhet të ketë përgjegjësi të përcaktuar, plan veprimi dhe rezultat të matshëm.

1. Roli i Bashkisë së Libohovës

Bashkia duhet të jetë institucioni kryesor koordinues për:
menaxhimin e vlerave të territorit;

hartimin e projekteve;

zhvillimin ekonomik;

mbështetjen e prodhuesve;

promovimin turistik.

Ajo duhet të jetë jo vetëm administratore, por udhëheqëse e zhvillimit.

2. Menaxhimi profesional i pasurive

Çdo aset duhet të ketë:

gjendjen aktuale;

problemet;

masat konkrete;

institucionin përgjegjës;

afatet;

rezultatet e pritshme.

Nuk mjafton të thuhet: “e vizituam dhe e promovuam”.

Duhet të ketë punë konkrete që një monument, produkt apo resurs të kthehet në vlerë reale.

3. Bashkëpunimi institucional

Realizimi i këtij modeli kërkon bashkëpunimin e:

Bashkisë;

institucioneve qendrore;

specialistëve;

komunitetit;

sipërmarrësve lokalë;

diasporës.

Zhvillimi nuk mund të realizohet nga një institucion i vetëm.

4. Libohova si bashki me status të veçantë zhvillimi

Për shkak të historisë, trashëgimisë, burimeve natyrore dhe potencialeve ekonomike, Libohova duhet të trajtohet si një territor me karakteristika të veçanta.

Kjo nuk është kërkesë për privilegj, por për një model administrimi që i përshtatet realitetit dhe potencialit të saj.

V. MODELI I ADMINISTRATËS PROFESIONALE DHE QEVERISJES EFEKTIVE LOKALE

Nga administrimi rutinë te administrimi i bazuar në dije, përgjegjësi dhe shërbim

Një model i tillë zhvillimi kërkon një administratë moderne, profesionale dhe efikase.

1. Parimet e administratës moderne

Administrata duhet të bazohet në:

profesionalizëm;

vazhdimësi institucionale;

përgjegjësi të qarta;

transparencë;

përdorim të teknologjisë.

2. Administratë e vogël, profesionale dhe e digitalizuar

Bashkia nuk ka nevojë për një administratë të madhe, por për një administratë:

të vogël;
funksionale;
të trajnuar;
të digitalizuar;
të orientuar drejt qytetarit.
Çdo punonjës duhet të ketë:
detyrë të përcaktuar;
objektiva konkrete;
tregues matës të punës;
përgjegjësi për rezultatet.

Punonjësit duhet të pajisen me mjetet e nevojshme për të ofruar shërbime cilësore.

3. Organograma funksionale sipas modeleve europiane

Struktura administrative duhet të organizohet sipas funksioneve reale:

shërbimet ndaj qytetarëve;
zhvillimi ekonomik, bujqësia dhe agroekoturizmi;
trashëgimia dhe turizmi;
mjedisi, pyjet dhe burimet natyrore;
financat dhe projektet.

Qëllimi nuk është kopjimi i modeleve të huaja, por përshtatja e praktikave më të mira europiane me nevojat e Libohovës.

4. Këshilli Bashkiak si organ i vërtetë përfaqësues

Këshilli Bashkiak duhet të jetë institucion aktiv i demokracisë vendore.

Ai duhet të:

përfaqësojë komunitetin;
miratojë politikat e zhvillimit;
kontrollojë zbatimin e vendimeve;
kërkojë llogaridhënie;
garantojë transparencën.

Anëtarët e tij duhet të zgjidhen mbi bazën e besimit të qytetarëve, integritetit dhe aftësisë për të kontribuar, jo vetëm mbi përkatësinë politike.

PËRFUNDIME

Libohova nuk duhet të vlerësohet vetëm si një territor administrativ, por si një hapësirë me identitet të veçantë historik, kulturor, natyror dhe ekonomik.

E ardhmja e saj kërkon:

ruajtjen e identitetit;
administrimin profesional të vlerave;
zhvillimin ekonomik mbi bazën e burimeve lokale;
një administratë moderne dhe të përgjegjshme;
përfaqësim real të komunitetit.

Për realizimin e këtij vizioni kërkohet angazhimi i të gjithë strukturave shtetërore dhe i gjithë spektrit politik, duke lënë mënjanë interesat e ngushta partiake dhe duke vendosur në qendër interesin e komunitetit dhe të zhvillimit afatgjatë.

Modelet europiane të qeverisjes vendore tregojnë se territoret me identitet të veçantë nuk dobësohen duke u menaxhuar me standarde të veçanta, por përkundrazi bëhen shembuj zhvillimi.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA LIBOHOVË
KËSHILLI BASHKIAK LIBOHOVË

Nr. 1668/15 prot

Libohovë më 10.08.2026

PETICION

DREJTUAR: KOMISIONIT TË POSAÇËM PARLAMENTAR PËR REFORMËN
ADMINISTRATIVO-TERRITORIALE

KUVENDIT TË REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

Adresa: Bulevardi "Dëshmorët e Kombit", Tiranë

PËR DIJENI: MINISTRISË SË SHTETIT PËR PUSHTETIN VENDOR
DEPUTETËVE TË QARKUT GJIROKASTËR

LËNDA: Peticion për kundërshtimin zyrtar të projektligjit "Për ndarjen
administrativo-territorial të njërive të qeverisjes vendore në Republikën e
Shqipërisë"

KREU I: PARATHËNIE DHE DEKLARIM I INTERESIT PUBLIK

Ky material përpilohet dhe dorëzohet në emër të Këshillit Bashkiak, grupeve të interest dhe komunitetit të banorëve të Bashkisë Libohovë. Ky qëndrim nuk udhëhiqet nga asnjë lloj interesi personal, por ekskluzivisht nga interesi i lartë publik i banorëve tanë. Qëllimi i këtij dokumenti është të argumentojë shkencërisht, logjistikisht dhe juridikisht se projektligji për shkrirjen e Bashkisë Libohovë cenon parimet kushtetuese të vetëqeverisjes vendore dhe autonomies funksionale.

KREU II: REALITETI DEMOGRAFIK DHE SHPËRNDARJA E TERRITORIT

Bashkia Libohovë shtrihet në një sipërfaqe zyrtare prej **248.24 km²**. Bazuar në të dhënat e sakta të Regjistrit të Gjendjes Civile, popullsia e regjistruar e bashkisë është **6,830 banorë**. Ndarja e

brendshme sipas njësive administrative pasqyron një thyerje të rëndë gjeografike dhe tregues kritikë të dendësisë:

- **Njësia Administrative Libohovë (Qyteti):** Sipërfaqe prej ~2.60 km², me **3,110 banorë**. Dendësia: 1,196.1 banorë/km².
- **Njësia Administrative Qendër Libohovë (7 fshatra):** Sipërfaqe prej ~114.64 km², me **2,620 banorë**. Dendësia: 22.8 banorë/km². (Përfshin fshatrat: Labovë e Sipërme, Labovë e Poshtme, Suhë, Stegopull, Bulo, Drino, Nepravishtë).
- **Njësia Administrative Zagorie (10 fshatra):** Sipërfaqe prej ~131.00 km², me **1,100 banorë**. Dendësia: **8.3 banorë/km²**. (Përfshin fshatrat: Sheper, Nivan, Konckë, Vithuq, Hoshtevë, Doshnicë, Zhej, Lliar, Topovë, Nderan).

Mbi argumentet e përdorura për riorganizimin territorial të Bashkisë Libohovë:

Ndryshimi i hartës administrativo-territoriale është një nga vendimet më të rëndësishme që prek historinë, identitetin, administrimin dhe zhvillimin e një komuniteti. Pikërisht për këtë arsye, çdo argument që përdoret për ta mbështetur duhet të jetë i plotë, objektiv, i verifikueshëm dhe i mbështetur në fakte.

Nga analiza e materialeve të bëra publike rezultojnë një sërë çështjesh që kërkojnë rishqyrtim:

Së pari, popullsia. Shifrat e Censit 2023 janë marrë si bazë kryesore e analizës, ndërkohë që nuk është bërë një ballafaqim me regjistrat e gjendjes civile, listat e zgjedhësve, të dhënat administrative dhe verifikimin në terren për çdo familje. Në zona me emigracion të lartë dhe lëvizje sezonale, një tregues i vetëm nuk mund të shërbejë si bazë e vetme për një vendim kaq të rëndësishëm.

Së dyti, interpretimi i historisë. Historia nuk mund të përdoret në mënyrë selektive. Libohova është një qytet historik me identitet të veçantë dhe me rol të dokumentuar administrativ ndër shekuj. Po kështu, fakti që Lunxhëria ka qenë pjesë e nënprefekturës së Libohovës është një realitet historik që nuk mund të anashkalohet. Prandaj, çdo interpretim që krijon përshtypjen e zbehjes së identitetit historik të Libohovës kërkon argumentim shkencor dhe dokumentar.

Së treti, identiteti historik dhe kulturor. Libohova nuk mund të vlerësohet vetëm në raport me zonat përreth. Ajo ka trashëgiminë, traditat, monumentet, institucionet dhe zhvillimin e saj historik, të cilat përbëjnë një identitet të konsoliduar.

Së katërti, kriteret ekonomike. Nuk mjafton analiza e të ardhurave dhe shpenzimeve aktuale. Duhet të vlerësohen edhe potencialet e zhvillimit në turizëm, bujqësi, agropërpunim, trashëgimi kulturore, burime natyrore dhe ekonomi vendore, të cilat mund të ndryshojnë ndjeshëm perspektivën e zhvillimit të bashkisë.

Së pesti, shërbimet publike. Nuk është e mjaftueshme të thuhet se ato do të përmirësohen. Duhet të paraqiten analiza konkrete mbi ndikimin që do të ketë riorganizimi në aksesin e qytetarëve,

cilësinë e shërbimeve, kohën e marrjes së tyre dhe kostot shtesë.

Së gjashti, konsultimi publik. Përfshirja e qytetarëve nuk duhet të jetë vetëm një procedurë formale. Një reformë me pasoja afatgjata kërkon dëgjim real të komunitetit dhe marrjen në konsideratë të mendimeve të tij.

Së shtati, mungesa e analizës së alternativave. Çdo reformë serioze duhet të shqyrtojë edhe zgjidhje të tjera të mundshme, përfshirë modele të suksesshme evropiane për bashki të vogla historike dhe turistike, përpara se të propozojë shkrirjen e një njësie vendore.

Në përfundim, një vendimmarrje me rëndësi kombëtare nuk duhet të mbështetet mbi interpretime të pjesshme apo mbi tregues të vetëm statistikorë. Ajo duhet të ndërtohet mbi analiza të plota, të dhëna të verifikuara, respekt për historinë, identitetin dhe potencialin zhvillimor të çdo bashkie.

Libohova meriton një vlerësim të drejtë, objektiv, profesional dhe të paanshëm. Vetëm mbi këtë bazë mund të ndërtohen reforma që i shërbejnë interesit publik dhe zhvillimit të qëndrueshëm.

KREU III: ARGUMENTET KU BAZOHET KUNDËRSHTIMI I SHKRIRJES

3.1. Anomalia e Organit Përfaqësues (Këshilli me 15 Anëtarë)

Sipas ligjit, Këshilli Bashkiak i Libohovës përbëhet nga **15 anëtarë**. Kjo përfaqëson një raport prej **1 këshilltari për çdo 455 banorë**, një tregues unik mbingarkese në krahasim me mesataren kombëtare.

Për më tepër, në një territor prej 248.24 km², çdo anëtar mbulon matematikisht **16.5 km²**. Për shkak të izolimit dhe thyerjes malore, kjo structure minimale e ka të pamundur të mbulojë dhe monitorojë cilësisht nevojat e fshatrave nëse qendra administrative largohet më tej.

3.2. Parimi i "Qytetarit të Fundit" dhe Izolimi Gjeografik (Rasti i Doshnicës, Konckës dhe Lliarit)

Filozofia e decentralizimit sanksionon se shteti duhet të ofrojë shërbime pranë qytetarit, edhe nëse në një fshat ka mbetur një banor i vetëm. Fshatrat **Doshnicë, Konckë dhe Lliar** ndodhen aktualisht në vështirësi totale infrastrukturore.

Zhvendosja e administrates në Gjirokastër do të thotë që një banor i këtyre zonave të thella duhet të udhëtojë me orë të tëra në rrugë të thyera rurale dhe nacionale vetëm për një certifikatë apo shërbim minimal. Kjo formë reformimi nuk sjell efikasitet, por braktisje institucionale, sidomos në stinën e dimrit për menaxhimin e emergjencave civile dhe bllokimit nga dëbora.

3.3. Trashëgimia Historike dhe kulturore, pasuritë ujore, bimët medicinale dhe nevoja për lehtësira

Libohova nuk është një njësi administrative e krijuar rishtazi. Ajo ka një vazhdimësi institucionale më shumë se një shekull. Në vitin 1914, Libohova u shpall Nënprefekturë. Ky vendim nuk ishte rastësor, por lidhej me pozitën e saj strategjike kufitare, traditën administrative, rëndësinë historike dhe aftësinë për të administruar një territor me veçori të veçanta. Në

juridiksionin e Nënprefekturës u përfshinë edhe zona të banuara nga minoriteti kombëtar grek. Kjo dëshmonte besimin që shteti shqiptar i kishte dhënë Libohovës për administrimin e një territori të rëndësishëm dhe për garantimin e zbatimit të ligjit dhe bashkëjetesës ndërmjet komuniteteve.

Edhe sot, në territorin e Bashkisë së Libohovës jetojnë qytetarë që i përkasin minoritetit kombëtar grek, të cilëve u garantohen të drejtat e parashikuara nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, legjislacioni shqiptar dhe konventat ndërkombëtare.

Pas vitit 1944, organizimi i pushtetit vendor ndryshoi sipas zhvillimeve politike të vendit, por Libohova vazhdoi të ruante rolin e saj administrativ. Ajo kaloi në formë të ndryshme organizimi: Lokalitet, Këshill Popullor, Këshill pluralist, Bashki dhe më pas Bashki me territor të zgjeruar. Kjo kronologji tregon qartë se zhvillimi administrativ i Libohovës ka qenë progresiv. Në çdo periudhë, pavarësisht ndryshimeve të sistemeve, ajo ka ruajtur funksionin e saj si qendër e administrimit vendor.

Reforma administrativo-territoriale e vitit 2015 nuk e hoqi statusin e Libohovës, por e zgjeroi territorin e saj dhe i dha përgjegjësi të reja. Kjo dëshmon se zgjidhja e parë ka qenë forcimi i funksioneve të saj, jo eliminimi i rolit të saj institucional. Në vlerësimin e një reforme të re nuk mund të përdoren vetëm tregues numerikë. Një territor nuk është vetëm numër banorësh apo sipërfaqe. Ai është histori, identitet, trashëgimi, burime natyrore, ekonomi dhe mundësi zhvillimi. Libohova ka vlera të rëndësishme historike, kulturore dhe natyrore, ka pozitë strategjike kufitare dhe potencial të madh për zhvillimin e agro-turizmit, turizmit kulturor dhe ekonomisë lokale. Për t'i kthyer këto vlera në zhvillim nevojitet një qeverisje që njeh territorin dhe është pranë qytetarëve.

Në këtë kuadër, duhet të diskutohet me seriozitet edhe koncepti i qeverisjes me "qytet". Një ndryshim i tillë nuk mund të konsiderohet automatikisht zhvillim vetëm sepse krijon njësi më të mëdha. Zhvillimi nuk matet me madhësinë e strukturës administrative, por me efektivitetin, afërsinë me qytetarin dhe aftësinë për të menaxhuar potencialet e territorit. Për komunitete si Libohova, me histori të gjatë administrative, me zona rurale, malore dhe me pasuri të veçanta, përqendrimi i vendimmarrjes në një qendër më të madhe rrezikon të dobësojë përfaqësimin lokal dhe të largojë institucionet nga qytetari.

Një model i tillë do të ishte regres nëse do të sillte humbjen e autonomisë vendore, dobësimin e identitetit territorial dhe largimin e vendimmarrjes nga komuniteti. Përkundrazi, standardet moderne evropiane tregojnë se edhe njësitë e vogla vendore mund të jenë të suksesshme kur kanë administratë profesionale, përdorin teknologjinë, menaxhojnë mirë burimet dhe ndërtojnë politika të përshtatura për territorin. Prandaj, pyetja kryesore nuk duhet të jetë: "Sa e madhe është një njësi administrative?", por: "Sa efektive është ajo për t'i shërbyer qytetarit dhe për të zhvilluar territorin?"

Libohova nuk kërkon një trajtim të veçantë. Ajo kërkon që historia e saj, roli institucional, pozita strategjike dhe potenciali zhvillimor të vlerësohen drejt. Ruajtja e Bashkisë së Libohovës nuk është vetëm çështje e një strukture administrative. Është ruajtje e një vazhdimësie institucionale mbi një shekull, e një identiteti territorial dhe e një mundësie zhvillimi për brezat që vijnë.

Libohova, Zagoria dhe Labova mbartin një histori unike kombëtare, pasuri të paçmueshme kulturore (si Kisha e Labovës së Kryqit, Kalaja e Libohovës) dhe një potencial të jashtëzakonshëm të zhvillimit të turizmit dhe grumbullimit të bimëve medicinale.

Pasuritë ujore të Bashkisë Libohovë: (Kapital natyror, ekonomik dhe institucional për zhvillimin e qëndrueshëm dhe forcimin e autonomisë vendore)

Territori i Bashkisë Libohovë përfaqëson një hapësirë me vlera të rëndësishme natyrore, historike, kulturore dhe ekonomike. Ndër pasuritë më të rëndësishme të këtij territori janë pasuritë ujore, të cilat përbëjnë një kapital strategjik për zhvillimin e qëndrueshëm të komunitetit.

Burimet e Zhepës, Lozës, Zervoit, etj. në Libohovë; Vrizi në Nepravishtë; burimet ujore të Labovës së Kryqit, Suhës, Stegopulit, Sheperit dhe fshatrave të tjera të Zagorisë; si dhe rezervuarët e Doftisë, Suhës dhe Sheperit, janë vlera natyrore që kanë mbështetur jetën dhe ekonominë e komuniteteve ndër breza. Këto pasuri nuk kanë vetëm rëndësi mjedisore. Ato përfaqësojnë mundësi konkrete për zhvillimin e bujqësisë dhe blegtorisë; mbështetjen e ekonomisë rurale; zhvillimin e agroturizmit dhe ekoturizmit; ruajtjen e biodiversitetit dhe forcimin e ekonomisë së gjelbër.

Në vlerësimin e një territori nuk mund të përdoret vetëm kriteri i numrit të banorëve. Një analizë moderne duhet të marrë në konsideratë edhe pasuritë natyrore, potencialin ekonomik, trashëgiminë historike, pozicionin gjeografik dhe përgjegjësitë që mbart një njësi vendore. Pasuritë ujore të Bashkisë Libohovë janë pjesë e kapitalit publik të territorit dhe duhet të shërbejnë për zhvillimin e komunitetit që i ka trashëguar dhe administron.

Uji është një nga pasuritë më të rëndësishme të natyrës dhe një faktor themelor për zhvillimin e çdo territori. Historikisht, vendbanimet njerëzore janë krijuar dhe zhvilluar pranë burimeve ujore, sepse uji ka qenë baza e jetës, bujqësisë, blegtorisë dhe veprimtarisë ekonomike. Edhe territori i Libohovës është zhvilluar në lidhje të ngushtë me burimet e tij natyrore. Relievi malor, kushtet klimatike dhe struktura gjeologjike kanë krijuar një pasuri të veçantë ujore, e cila përbën një element të rëndësishëm të identitetit të territorit. Këto burime nuk janë vetëm elemente natyrore, por një kapital që lidhet me të ardhmen e zhvillimit lokal.

Burimet ujore në Libohovë:

Burimi i Zhepës është një nga pasuritë ujore të rëndësishme të territorit të Libohovës. Ai përfaqëson një vlerë natyrore me rëndësi për komunitetin dhe mjedisin. Prej tij furnizohet edhe fabrika "Partner Ballkanik" për prodhimin e lëngut të frutave "Amita"; Burimi i Lozës është pjesë e trashëgimisë natyrore të zonës dhe dëshmon lidhjen e hershme të komunitetit me burimet

ujore; Burimi i Zervoit plotëson pasurinë ujore të territorit dhe ka rëndësi për ruajtjen e ekuilibrit natyror dhe mundësitë e zhvillimit të turizmit natyror. Dikur nga ky burim furnizohej me ujë edhe punishtja e përpunimit të qumështit në Libohovë.

Burimet ujore në njësitë administrative:

Vrizi i Nepravishtës është një burim i rëndësishëm për komunitetin lokal dhe lidhet me traditën e përdorimit të ujit në zonat rurale. Prej tij në Glinë ambalazhohet edhe uji " Spring". Labova e Kryqit kombinon vlerat historike, kulturore dhe natyrore. Burimet ujore të saj janë pjesë e këtij identiteti dhe një faktor i rëndësishëm për zhvillimin e turizmit të qëndrueshëm. Burimet e ujit të Suhës, Stegopulit, Sheperit dhe Zagorisë kanë mbështetur ndër breza jetën e komuniteteve, bujqësinë dhe blegtorinë tradicionale. Ato janë pjesë e një pasurie natyrore që lidhet me: peizazhin; kulturën lokale; turizmin malor; ekonominë rurale. Nga Burimi i Ujit të Bambolit në Sheper ambalazhohet edhe uji "Living".

Rezervuarët ujorë:

Rezervuari i Doftisë përbën një pasuri të rëndësishme për territorin e Bashkisë Libohovë. Ai ka vlera për: bujqësinë; ruajtjen e rezervave ujore; peizazhin natyror; aktivitetet rekreative. Rezervuarët e Suhës dhe Sheperit kanë rëndësi për ekonominë rurale dhe për qëndrueshmërinë e veprimtarive bujqësore e blegtorale.

Vlerat mjedisore:

Pasuritë ujore janë pjesë e ekosistemit natyror të territorit. Ato kontribuojnë në: ruajtjen e biodiversitetit; mbrojtjen e peizazhit; ruajtjen e ekuilibrit ekologjik. Në kushtet e ndryshimeve klimatike, mbrojtja dhe menaxhimi i burimeve ujore është një përgjegjësi strategjike.

Vlerat ekonomike:

Pasuritë ujore krijojnë mundësi zhvillimi në disa fusha, të cilat përfshijnë:

Bujqësinë dhe blegtorinë: Uji është baza e prodhimit bujqësor dhe blegtoral dhe ndikon në ruajtjen e ekonomisë rurale. Agroturizmi dhe ekoturizmi. Burimet ujore, së bashku me trashëgiminë kulturore të Libohovës, Nepravishtës, Labovës së Kryqit, Suhës, Stegopulit dhe Zagorisë, krijojnë mundësi për një model turizmi të qëndrueshëm.

Ekonominë e gjelbër: Administrimi i qëndrueshëm i burimeve natyrore mund të krijojë mundësi të reja ekonomike dhe punësimi.



Baza ligjore dhe autonomia vendore:

Administrimi i pasurive të territorit lidhet me parimet e vetëqeverisjes vendore. Ligji nr. 139/2015 "Për Vetëqeverisjen Vendore" përcakton rolin e bashkive në: zhvillimin ekonomik vendor; mbrojtjen e mjedisit; planifikimin e territorit. Autonomia vendore kërkon që njësitë vendore të kenë mundësi reale për të zhvilluar territoret që administrojnë. Parimi themelor është: Pasuritë e territorit duhet të kontribuojnë në zhvillimin e territorit.

Standardi evropian:

Karta Evropiane e Vetëqeverisjes Vendore mbështetet në: autonominë vendore; parimin e subsidiaritetit; burime të përshtatshme për ushtrimin e kompetencave. Këto parime tregojnë se komunitetet lokale duhet të kenë rol real në menaxhimin e çështjeve që lidhen me territorin e tyre.

Modele evropiane krahasuese:

Hallstatt në Austri tregon se një komunitet i vogël mund të ketë rëndësi të madhe për shkak të vlerave natyrore dhe historike. ndërsa Zagori në Greqi dëshmon se zonat malore mund të zhvillohen duke përdorur natyrën, burimet ujore dhe trashëgiminë kulturore. Modelet e komunave malore të Italisë dhe Zvicrës tregojnë se territoret me pasuri natyrore mund të jenë njësi të qëndrueshme kur administrohen me përgjegjësi.

Pasuritë ujore të Bashkisë Libohovë janë një kapital natyror, ekonomik dhe institucional. Ato përbëjnë një argument të rëndësishëm se vlerësimi i territorit duhet të jetë i plotë dhe jo i kufizuar vetëm në tregues demografikë.

Bashkia Libohovë disponon pasuri që lidhen me: zhvillimin ekonomik; mbrojtjen e mjedisit; turizmin; identitetin historik dhe kulturor. Për këtë arsye, këto pasuri duhet të jenë pjesë e strategjisë së zhvillimit vendor dhe e çdo vlerësimi të ardhshëm territorial. Një territor nuk vlerësohet vetëm nga numri i banorëve, por nga vlerat që mbart, pasuritë që administrojnë dhe mundësitë që krijon për brezat e ardhshëm. Janë këta disa prej shumë treguesve të tjerë pse Bashkia Libohovë duhet të vazhdojë ruajtjen e statusit Bashki dhe jo Qytet.

Nëse dëshira e banorëve për të zhvilluar zonën e tyre do të bëhet realitet, kjo nuk mund të arrihet duke mbyllur institucionet publike. Përkundrazi, kërkohet mbajtja e administratës afër për t'u krijuar lehtësira burokratike, thithet investime dhe ndërtuar infrastrukturën që u mungon këtyre fshatrave.

Popullsia reale e Bashkisë Libohovë dhe domosdoshmëria e korrigjimit të një vlerësimi të gabuar:

Bashkia Libohovë përfaqëson një territor me identitet të konsoliduar historik, gjeografik dhe shoqëror, i cili është formuar dhe zhvilluar përgjatë mijëra viteve. Për këtë arsye, çdo vlerësim për të ardhmen e saj duhet të mbështetet mbi realitetin e plotë dhe jo mbi tregues të shkëputur nga faktet administrative, historike dhe zhvillimore.

Sipas Regjistrit Themeltar të Gjendjes Civile, popullsia aktuale e Bashkisë Libohovë është 6.830 banorë. Ky është regjistri administrativ mbi të cilin shteti mbështet marrëdhëniet juridike dhe administrative me qytetarët, listat e zgjedhësve dhe organizimin e shërbimeve publike vendore. Ndërkohë, shifra prej 2.765 banorësh e paraqitur nga INSTAT-i nuk përputhet me realitetin administrativ dhe demografik të Bashkisë Libohovë. Kjo diferencë e madhe ka sjellë një pasqyrim të deformuar të numrit real të banorëve, pasi një evidentim në një moment të caktuar nuk mund të përjashtojë mijëra qytetarë që vazhdojnë të jenë të regjistruar në Gjendjen Civile, të kenë lidhje juridike me territorin dhe të jenë pjesë e jetës administrative të bashkisë. Ata janë banorë të përhershëm të Bashkisë Libohovë dhe askush nuk ka të drejtë ti fshijë nga lista.

Përdorimi i kësaj shifre pa një ballafaqim të plotë me të dhënat e Regjistrit të Gjendjes Civile ka sjellë një vlerësim të gabuar të peshës reale të Bashkisë Libohovë. Përpara çdo vendimmarrjeje administrativo-territoriale, institucionet kanë detyrimin të analizojnë me përgjegjësi të gjitha të dhënat dhe të japin një argumentim të qartë ligjor e metodologjik për bazën mbi të cilën mbështeten.

Por vlerësimi i Libohovës nuk mund të kufizohet vetëm te numri i banorëve. Ajo është një njësi territoriale me një pozicion të konsoliduar gjeografik, me vazhdimësi historike, kulturore dhe administrative, me pasuri natyrore, trashëgimi dhe potencial të rëndësishëm zhvillimi.

Përvoja e vendeve të Bashkimit Evropian tregon se ekzistenca dhe funksionimi i bashkive analoge nuk përcaktohet vetëm nga madhësia demografike, por edhe nga identiteti territorial, roli historik, funksionet që kryejnë dhe aftësia për të krijuar zhvillim të qëndrueshëm. Këto modele janë pjesë e argumenteve të paraqitura edhe në Memorandumin për vazhdimësinë dhe zhvillimin e Bashkisë Libohovë, së bashku me bazën ligjore shqiptare dhe parimet evropiane të autonomisë vendore.

Për korrigjimin e kësaj situatë kërkohet urgjentisht:

- rishikimi i të dhënave të përdorura për Bashkinë Libohovë;
- ballafaqimi zyrtar ndërmjet Regjistrit Themeltar të Gjendjes Civile dhe të dhënave statistikore;
- publikimi i bazës ligjore dhe metodologjike mbi të cilën është mbështetur përdorimi i këtyre treguesve;
- marrja në shqyrtim e argumenteve të Memorandumit dhe e përvojës së bashkive analoge në Bashkimin Evropian.

Nëse gabimet e evidentuara nuk korrigjohen në kohë, pasojat do të rëndojnë mbi komunitetin e Libohovës në drejtim të përfaqësimit, zhvillimit dhe organizimit të qeverisjes vendore. Përgjegjësia për një vendimmarrje të mbështetur mbi të dhëna të gabuara nuk mund t'i ngarkohet komunitetit, por atyre mekanizmave dhe institucioneve që kanë detyrimin të garantojnë një proces të drejtë, transparent dhe të argumentuar.

Në fund të fundit, Libohova ka qenë, është dhe do të jetë Libohovë, me të gjitha vlerat e saj historike, kulturore, gjeografike dhe shoqërore, të krijuara e të zhvilluara gjatë gjithë historisë së saj. Libohova nuk kërkon privilegje, por kërkon që të vlerësohet drejt mbi bazën e ligjit, realitetit të saj, historisë, identitetit dhe potencialit të zhvillimit.

Askush nuk ka të drejtë që, përmes një vlerësimi të gabuar apo një vendimmarrjeje të pamjaftueshme të argumentuar, ta çojë një territor me një identitet të konsoliduar drejt regresit.

KREU IV: STANDARDI I DYFISHTË NË REFORMËN TERRITORIALE

Nëse argument i hartuesve të reformës është numri i ulët i popullsisë, konstatohet një standard i dyfishtë flagrant. Drafti i ri mbron dhe mban të paprekuara plot 10 bashki të tjera me tregues të ngjashëm demografikë (nën 10,000 banorë), ndërsa Libohova penalizohet në mënyrë selektive.

- **Dropull:** Lejohet e pavarur (~448 km², Qarku Gjirokastrë).
- **Përmet:** Lejohet e pavarur (~601 km², Qarku Gjirokastrë).
- **Himarë:** Lejohet e pavarur, për shkak të specifikave strategjike.
- **Pustec:** Lejohet e pavarur, nën 5,000 banorë.

Pse argument i distances dhe specifikave gjeografike vlen për këto bashki, dhe nuk vlen për fshatrat tanë në vështirësi si Doshnica, Koncka apo Lliari ? Kjo vërteton mungesën e një kriteri objektiv dhe të barabartë ligjor.

KREU V: ARGUMENTET LIGJORE PSE PROJEKTLIGJI NUK DUHET TË MIRATOHET

Kuadri ligjor shqiptar lidhur me qeverisjen vendore, është i shtjelluar në disa akte juridike, mes të cilave më të rëndësishmet janë Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë dhe Karta Europiane e Autonomisë Vendore, e cila është ratifikuar nga Kuvendi i Republikës së Shqipërisë me ligjin 8548, datë 11.11.1999.

Projektligji, objekt kundërshtimi në këtë peticion, pretendon se është hartuar duke respektuar nenin 13 të Kushtetutës, i cili parashikon “Qeverisja vendore në Republikën e Shqipërisë, ngrihet në bazë të parimit të decentralizimit të pushtetit dhe ushtrohet sipas parimit të autonomisë vendore”, si dhe nenin 108, pika 2 i cili përcakton “**Ndarja administrativo-territoriale caktohet me ligj, mbi bazën e nevojave dhe interesave të përbashkët ekonomike, si dhe të traditës historike, ndërsa ndryshimi i kufijve kushtëzohet nga marrja paraprake e mendimit të popullsisë që banon në njësitë e prekura**”. Gjithashtu, pretendohet se ky propozim është në unison me përcaktimet e Kartës Europiane të Autonomisë Vendore, e cila kërkon që modeli i zgjedhur të garantojë aftësinë efektive të autoriteteve vendore për ushtrimin e

përgjegjëse të tyre, respektimin e subsidiaritetit, konsultimin paraprak për ndryshimet e kufijve dhe burime financiare të përshtatshme me kompetencat e ushtruara.

Për ta thjeshtësuar analizën vlen të theksojmë se këto kritere të përcaktuara nga korniza ligjore sa i takon qeverisjes vendore dhe ndryshimeve që mund të bëhen në ndarjet administrativo-territoriale janë trajtuar gjerësisht nga Gjykata Kushtetuese e Shqipërisë e cila në vendimin nr.19, datë 15.04.2015, është shprehur si më poshtë vijon.

“Gjykata vëren se neni 108 i Kushtetutës parashikon:

2. Ndarjet administrativo – territoriale të njësive të qeverisjes vendore caktohen me ligj mbi bazën e nevojave e të interesave të përbashkët ekonomikë dhe të traditës historike. **Kufijtë e tyre nuk mund të ndryshohen pa u marrë më parë mendimi i popullsisë që banon në to.**

Neni 5 i Kartës Europiane të Autonomisë Vendore shprehet:

Mbrojtja e kufijve territorial të bashkësive vendore

Për çdo ndryshim të kufijve territorial vendorë, bashkësive vendore përkatëse duhet t’u merret mendimi parapraksht, po qe nevoja, me anë referendumi, aty ku e lejon ligji.

Gjykata çmon me vend të ndalet fillimisht në konceptin kushtetues “të marrjes së mendimit nga popullsia” sipas nenit 108 të Kushtetutës, si kriter për kryerjen e një reforme administrativo-territoriale.

Gjykata çmon se koncepti i marrjes së mendimit nga popullsia që banon në NJQV, në rastet kur synohet ndryshimi i kufijve pjesorë ose tërësorë është detyrim kushtetues. Gjithashtu, duke qenë se mungon jurisprudenca e kësaj gjykate në lidhje me konceptin e marrjes së mendimit para bërjes së një reforme territoriale administrative, Gjykata për këtë qëllim i është referuar praktikës së Gjykatës Federale Gjermane, e cila ka elaboruar këtë koncept kushtetues si standard që duhet respektuar nga ligjvënësi.

- **Interesi publik si pikënisje për ndryshimin e kufijve të njësisë vendore:**

Për këtë arsye, në parim, shkrirja e komunave, bashkimi i tyre, ngjytja e tyre në një njësi tjetër ose çdo formë tjetër e ndryshimit të kufijve lokalë nuk prek thelbin e vetëqeverisjes lokale si garanci kushtetuese. Megjithatë, **çdo ndryshim që prek kufijtë e njësive vendore duhet të ketë si pikënisje interesin publik dhe të jetë i bazuar edhe mbi mendimin e komunitetit të prekur nga ndryshimet (Vendim i GJFK-së gjermane: BverfGE 86, 90, 12 maj 1992).**

- **Me rëndësi thelbësore është sa më poshtë ka evidentuar Gjykata Kushtetuese lidhur me marrjen dijeni për rregullimin e ri:**

Gjykata e sheh me vend të nënvizojë se detyrimi për të dëgjuar NJQV-të që preken nga ndryshimi i kufijve të tyre (nëpërmjet ndarjes së re apo çdo lloj riorganizimi), nënkupton që njësitë të marrin dijeni/informacion për rregullimin e ri. Informacioni duhet të përfshijë përmbajtjen substanciale të riorganizimit, si dhe arsyet përkatëse që çuan në këtë rregullim të ri.

- **Koncepti i NJQV-ve si pjesmarrës në reformë, jo si objekte të veprimtarisë së pushtetit qendror:**

Qëllimi i mundësisë për t'u dëgjuar është që NJQVtë të mos kthehen në objekt të veprimtarisë së pushtetit qendror, por të jenë pjesmarrës në reformë.

- **Gjykata Kushtetuese ka elaboruar konceptin e “testit të proporcionalitetit”:**

Gjykata thekson se vendimmarrja e ligjvënësit në lidhje me një ndarje të re administrativo-territoriale të vendit është e nevojshme t'i nënshtrohet testit të proporcionalitetit, i cili duhet të peshojë interesa të ndryshëm të të gjithë subjekteve që preken nga reforma. Ky test nuk mund të japë rezultate të sakta pa pjesmarrjen e të gjithë subjekteve. Nëpërmjet këtij testi, ligjvënësi mbledh informacion mbi të gjitha çështjet e ndjeshme që përfshihen në një reformë të mundshme. Për këtë arsye, e drejta e komunitetit për t'u dëgjuar para ndërhyrjes së ligjvënësit në kufijtë territorial të hapësirës administrative ku ai jeton, është jo vetëm përmbajtja materiale e garancisë objektive të vetëqeverisjes vendore, por edhe element i shtetit të së drejtës, i cili ka për synim funksionimin siç duhet të të gjithë pushtetit shtetëror.

- **Mundësia e ndryshimit të propozimit, pas konsultimit me banorët, është një kriter shumë i rëndësishëm që shtjellohet nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese Gjermane, sipas të cilës:**

Gjykata çmon se pavarësisht detajeve, procesi i dëgjimit duhet të përfshijë si kusht minimal pjesmarrjen formale të banorëve të NJQV-ve që preken nga reforma në një proces diskutimi, ku jo vetëm të paraqitet variant përfundimtar që do të miratohet, por ai të jetë i hapur për ndryshime të mundshme, sipas sugjerimeve të komunitetit aty ku ka. (Vendim i GJK-së së Landit të Brandenburgut: nVfGBbg, 18 dhjetor 2003)

- **Pluraliteti i metodave prej nga merret mendimi i banorëve si kusht për një rezultat më të besueshëm:**

Nisur nga standardet e shprehura më lart, Gjykata konstaton se referuar edhe ligjit nr.8652/2000, i cili parashikon si metoda alternative të marrjes së mendimit: mbledhjet e hapura, seancat e këshillimit me publikun, dëgjimet publike, sondazhet e opinionit të certifikuara nga organe kompetente ose qëndrimin e shprehur nëpërmjet referendumit vendor ose në ndonjë mënyrë tjetër të përshtatshme dhe të besueshme, nuk është e domosdoshme për haruesin e ligjit që këto metoda të konsultimit të plotësohen të gjitha njëherësh, me qëllim që ky proces të quhet i kryer. **Natyrisht sa më shumë prej këtyre metodave të përdoren, aq më i besueshëm dhe i qëndrueshëm është rezultati**".

Lidhur me sa u parashtrua më sipër, duke analizuar gjithë kriteret që Gjykata Kushtetuese e Republikës së Shqipërisë ka evidentuar si të domosdoshme kur bëhet fjalë për reforma administrativo-territoriale, na rezulton se nga ana e Komisionit të Posaçëm Parlamentar, ato janë zbatuar vetëm formalisht, por jo duke mishëruar në thelb ato çka janë elaboaruar nga jurisprudenca e Gjykatës Kushtetuese.

Sipas relacionit të hartuar për të përligjur Projektligjin që propozohet të miratohet rezulton se procesi konsultativ diagnostik i Komisionit të Posaçëm, përfshiu 23 mbledhje e seanca dhe 11 dëgjesa publike rajonale. Mirëpo, ajo që përpiqet të eklipsohet është fakti se në masën dërmuese nga këto procese konsultative, doli në pah vullneti i përgjithshëm dhe i palëkundur i banorëve të këtyre zonave për moshkrirjen e bashkive të tyre, çka përforcohet edhe nga protestat mbarë popullore në të gjitha bashkitë që janë propozuar të suprimohen. Arsyet pse protestohet janë të thjeshta; kjo reformë anashkalon plotësisht parimin e subsidiaritetit (shërbimet sa më afër qytetarëve) që mund të tingëllojë i vështirë për ata që nuk kanë informacionin e duhur, por që për njerëzit e thjeshtë, që banojnë në zonat më të thella nënkupton mbijetesën, sepse nëse shërbimet nuk janë afër, jeta e tyre vështirësohet në një mënyrë të papërshkrueshme.

Pa një analizë të mirëfilltë të të gjithë kriterëve të renditura më sipër, çdo vendimmarrje e pa studiuar do të ishte, përveçse jo në përputhje me jurisprudencën, njëkohësisht edhe "vrastare" për të ardhmen e banorëve të bashkive që janë pjesë e propozimit të sipërcituar.

KREU VI: KONKLUZIONE DHE KËRKESA FINALIZUESE

Për sa më sipër, në emër të komunitetit dhe grupeve të interesit të Bashkisë Libohovë, kërkojmë zyrtarisht nga Komisioni Parlamentar:

1. **Rrëzimin e propozimit** për shkrirjen e Bashkisë Libohovë dhe ruajtjen e statusit të saj aktual administrativ.
2. **Organizimin e një dëgjese publike** pranë Kuvendit të Shqipërisë me përfaqësuesit e zgjedhur të komunitetit tonë përpara marrjes së çdo vendimi, që cenon interesat dhe të ardhmen e të gjithëve.